

## Vendim nr. 114 datë 24.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 24.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (P) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

### **KËRKUES:**

**PËRPARIM CELIBASHI**

### **OBJEKTI:**

**Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4461, datë 17.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.**

**Konstatimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.**

**Dëmshpërblimi 10.000 (dhjetë mijë) euro, sipas nenit 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*) dhe paragrafit 204 të vendimit të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (*GJEDNJ*) të datës 11 janar 2018.**

### **BAZA LIGJORE:**

**Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Përparim Celibashi (*kërkuesi*) ka shërbyer në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë si oficer aktiv, me gradë “Kapiten i Parë”, nga viti 1971 deri në vitin 1999, kur me urdhër të ministrit të Mbrojtjes ka dalë në rezervë si pasojë e reformës në ushtri.

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e vendimit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë (*DRSSH, Tiranë*) për mbylljen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe detyrimin e kësaj të fundit të paguajë një pension bazë nga data 01.06.2006 deri më 01.07.2009. Kërkuesi ka kërkuar edhe detyrimin e të paditurit, DRSSH-së Tiranë, të llogarisë dhe paguajë diferencën e pensionit sipas ligjit.

3. Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2106, datë 06.03.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe rrëzimin për pjesën e kërimit për detyrimin e palës së paditur DRSSH-së, Tiranë për t'i paguar diferencat e dala si rezultat i rillogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi nga data 01.07.2009 dhe në vazhdim.

4. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga palët dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me ndryshimin që diferencat e dala si rezultat i rillogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të paguhen për periudhën nga 30.05.2006 deri në 30.06.2009. Ky vendim është kthyer në titull ekzekutiv dhe është vënë në ekzekutim në favor të paditësit.

5. DRSSH-ja, Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka rillogaritur masën e pensionit të parakohshëm, për shkak se kërkuesi rezultonte i punësuar, duke e nxjerrë debitor ndaj DRSSH-së, Tiranë. Kërkuesi është ankuar në DRSSH-në, Tiranë dhe në Institutin e Sigurimeve Shoqërore lidhur me këtë fakt dhe nga këto të fundit i është bërë me dije se pensioni i tij është rillogaritur dhe ai rezulton debitor në vlerën 784.281 lekë.

6. Në vijim, në datën 25.11.2014, kërkuesi i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ të DRSSH-së, Tiranë për ngarkesën debitore 784.281 lekë dhe për të gjitha efektet që rrjedhin prej tij, si dhe detyrimin e DRSSH-së, Tiranë për ta trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 18.045 lekë në muaj, sipas vendimit nr. 2106, datë 06.03.2012, deri

në datën 14.01.2014. Ai ka kërkuar nga gjykata edhe pagesën e diferencave të papaguara e të mbajtura padrejtësisht, si dhe detyrimin e pagimit të diferencave të papërfshira në masën e pensionit të parakohshëm bashkë me interesat e këtyre shumave deri në momentin e ekzekutimit të vendimit.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4524, datë 18.09.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, pasi kërkimet ishin të pabazuara në ligj dhe në prova. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2996 (3105), datë 28.06.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke argumentuar se shkaqet e ngritura në ankim nuk e cenojnë vendimmarrjen e kësaj të fundit, e cila ka qenë e ligjshme. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4461, datë 17.10.2023, në dhomë e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit për vendimin nr. 2996 (3105), datë 28.06.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se kërkuesi në rekurs nuk ka dhënë asnjë nga arsyet ligjore të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

9. Në datën 23.04.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

10.1. Gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar i është cenuar:

10.1.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ligjor*, pasi Gjykata e Lartë e ka marrë në shqyrtim çështjen e kërkuesit pas 6 vitesh pritje, duke tejkaluar ndjeshëm afatin e arsyeshëm.

10.1.2. *E drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë dhe e drejta për sigurime shoqërore*, pasi ai është privuar nga të drejtat e tij kushtetuese lidhur me masën e përfitimit të pensionit.

10.2. *Dëmshpërblim 10.000 (dhjetë mijë) euro*, sipas nenit 44 të Kushtetutës dhe paragrafit 204 të vendimit të GJEDNJ-së të datës 11 janar 2018.

## III

## Vlerësimi i Kolegjit

### A. Për legjitimimin e kërkesit

11. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, për pasojë mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

12. Ndër të tjera, kërkesi në ankimin e tij kushtetues ngre pretendime me natyrë substanciale, si cenimin e së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë dhe të *së drejtës për sigurime shoqërore*, pasi ai është privuar nga të drejtat e tij kushtetuese lidhur me masën e përfitimit të pensionit. Kolegji vëren se pavarësisht ngritjes së këtij pretendimi nga ana e kërkesit, vetë ai në ankimin kushtetues shprehet se nuk pret zgjidhje nga Gjykata lidhur me këtë pretendim. Për pasojë, Kolegji në vijim do të analizojë pretendimin e kërkesit që lidhet me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të gjyimit brenda një afati të arsyeshëm, si dhe kërkesën për dëmshpërblim.

13. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

14. Një kriter tjetër paraprak është shterimi i mjeteve juridike efektive, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkesi ka shteruar të gjitha

mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

15. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 13, datë 09.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces tej afatit të arsyeshëm ligjor, pasi rekursi është marrë në shqyrtim pas 6 vjetësh nga koha e paraqitjes së tij. Në lidhje me pretendimin për zhvillimin e një procesi tej afatit të arsyeshëm, dispozitat e KPC-së, që kanë hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2017, parashikojnë mjetet juridike për t'u mbrojtur nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Konkretisht, në këto dispozita përcaktohet kuptimi i afateve të arsyeshme (neni 399/2), mjetet e mbrojtjes nga cenimi, kërkesa për përsheptimin e gjykimit (neni 399/4), kërkesa për dëmshtëpërlim dhe kuptimi i shpërblimit të drejtë (neni 399/3), përcaktohet gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), marrja e vendimit (neni 399/8) etj. Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të cilat, sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, duke qenë se kërkuesi ka pretenduar kohëzgjatje të paarsyeshme nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se nuk rezulton që ai t'i jetë

drejtuar asaj gjykate me kërkesë për konstatimin e gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm, sipas nenit 399/6, shkronja “c”, të KPC-së, për rrjedhojë vlerësohet se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim.

18. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë që lidhen me legjitimitimin *ratione temporis* dhe *ratione materiae* bëhet i panevojshëm, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

19. Për sa i takon pretendimit të kërkuarit lidhur me dëmshpërblimin prej 10.000 (dhjetë mijë) eurosh, ky pretendim është jashtë juridiksionit kushtetues.

20. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.